



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Masat për adresimin e COVID-19 nga perspektiva gjinore

Rekomendime për Qeverinë e Kosovës

4 prill 2020

Pandemia globale COVID-19 po vazhdon të përhapet në shpejtësi të paparashikueshme dhe në përmasa globale. Shtetet në zhvillim dhe shtetet në kriza humanitare të cilat nuk kanë infrastrukturë të duhur ekonomike dhe shëndetësore do të pësojnë më së shumti¹. Historia tregon se në pandemi të tilla, pabarazitë sociale, dhe sidomos pabarazia gjinore është edhe më e theksuar. Është e rëndësishme që masat e marra ndaj pandemisë të jenë sensitive për nga perspektiva gjinore dhe të merren parasysh pozicionimet e grupeve të ndryshme në shoqëri dhe ekonomi, në mënyrë që të shmangët përkeqësimi edhe më tej i situatës, sidomos për grupet në margjinat e shoqërisë. Kriza ekonomike mund të shkaktojë përkeqësim dhe thellim të pabarazive gjinore dhe shoqërore por masat e marra si përgjigje ndaj pandemisë dhe krizës, mund të shkaktojnë dyfish pabarazi, në rast se janë neutrale dhe te bazuara te individit, por jo dhe në identitetet e ndryshme që i ka. Shtetet po e konfrontojnë virusin Korona me anë të masave emergjente dhe të jashtëzakonshme, në të cilat marrja parasysh e nevojave të ndryshme mes grave dhe burrave nuk konsiderohet primare nga qeveritë përkatëse.² Një mendësi e tillë reflekton edhe në masat e ndërmarra deri më tani nga qeveria e Republikës së Kosovës.

Situata aktuale

Me 11 Mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për marrjen e masave parandaluese në funksion të mbrojtjes nga Corona Virus COVID-19³. Ditën në vijim, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për themelimin e Komisionit të Posaçëm për parandalimin e përhapjes së Corona Virusit COVID-19 në Kosovë, të përbërë nga një numër minimal i grave nga institucionet përfaqësuese⁴. Masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për të luftuar pandeminë, mes tjerash konsistojnë në kufizim të

1 Duncan Maru, World Economic Forum (2020) 'Coronavirus is coming for the World 's poor. Here are six ways to help'.

2 'We are not aware of any gender analysis of the outbreak by global health institutions or governments in affected countries or in preparedness phases'. Wenham C., Smith J., Morgan R. (2020). COVID-19: the gendered impacts of the outbreak. Marrë nga:

[https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736\(20\)30526-2/fulltext](https://www.thelancet.com/journals/lancet/article/PIIS0140-6736(20)30526-2/fulltext).

3 <https://kryeministri-ks.net/aprovohen-masat-parandaluese-ne-funksion-te-mbrojtjes-nga-corona-virus-covid-19/>, 2020.

4 Qeveria e Kosovës ka themeluar Komisionin e posacem per parandalimin e Corona Virusit, Mars, 2020. Marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-ka-themeluar-komisionin-e-posacem-per-parandalimin-e-corona-virusit/>.

masave të lëvizjes për tërë qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërprerje të transportit ndër-urban në Kosovë, rritjen apo dyfishimin e shumës së asistencave sociale dhe pensionale⁵, për disa kategori si dhe përkrahjen e sektorit privat⁶ dhe për punëtorët e ekspozuar ndaj infektimit gjatë punës në terren⁷.

Njëkohësisht është krijuar edhe grupi ndërinstitutional për menaxhimin e incidenteve dhe aktivizimi i planit të reagimit kombëtar⁸. Këto masa nuk kanë marrë në konsideratë implikimet gjinore të situatës së krijuar nga COVID-19, dhe ato që pritet të krijohen. Duke qenë se Qeveria e Kosovës ka qenë ndër shtetet e prekura më së voni nga ky virus, ka pasur më shumë mundësi që të parashikojë minimumin e rreziqeve të aspektit social dhe ekonomik në Kosovë, specifikisht rreziqet që u kanosen grave dhe vajzave. Sidoqoftë RrGK nuk ka gjetur dëshmi që një praktikë e tillë është zbatuar, pa marrë parasysh se Qeveria e Kosovës sipas Ligjit për Barazi Gjinore, duhet të informohet për politikën dhe veprimet e ndërmarra nga analiza paraprake gjinore me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor⁹.

Masat e izolimit vecse kanë rezultuar me rritje të trefishuar të rasteve të dhunës në familje nëpër botë¹⁰. Në raste të izolimit dhe vështirësive financiare, si pasojë e mbylljes së veprimtarive ekonomike, dhuna në familje pritet të pësojë ngritje edhe në Kosovë¹¹. Izolimi do t'i vë gratë përballë abuzuesve të tyre për kohë më të gjatë, dhe në vështirësi të raportimit të dhunës¹². Edhe pse strehimoret të cilat janë në dispozicion për viktimat e dhunës për momentin janë duke e menaxhuar mirë situatën¹³, ato mund të mos kenë kapacitetet dhe fondet e duhura për të përballuar fluksin e viktimave në muajt e ardhshëm, dhe për t'i trajtuar ato me mjetet adekuate sanitare të nevojshme për këtë periudhë. Ndërkaq, problem shtesë në mungesën e trajtimit adekuat të viktimave të dhunës në familje paraqet mungesa e qasjes në shërbime psikologjike si pasojë e masave të izolimit, dhe mos-funksionimi i qendrave për punë

5 Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Vendim: Aprovohet Pakoja Emergjente Fiskale, Mars, 2020, marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeverisë-nga-Mbledhja-e-19.pdf>.

6 Aprovohen masat parandaluese në funksion të mbrojtjes nga Corona Virus COVID-19, Mars, 2020, marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/aprovohen-masat-parandaluese-ne-funksion-te-mbrojtjes-nga-corona-virus-covid-19/>

7 Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Vendim: Aprovohet Pakoja Emergjente Fiskale, Mars, 2020.

8 Ministria e Punëve të Brendshme, Vendim. marrë nga: [https://mpb.rks-gov.net/Documents/Vendimi%20112%20per%20PRK%20\(3\).pdf](https://mpb.rks-gov.net/Documents/Vendimi%20112%20per%20PRK%20(3).pdf).

9 Ligji për Barazi Gjinore, Neni 5, Paragrafi 1.

10 'In China, police reports show domestic violence has tripled during the epidemic. There is also some evidence that authorities have converted women's shelters into homeless shelters. In Italy, similar concerns have been raised about rising levels of domestic violence'. Fraser E. (2020).

Impact of COVID-19 Pandemic on Violence against Women and Girls. Marrë nga: <https://www.svri.org/sites/default/files/vaeg-helpdesk-284-covid-19-and-vaeg.pdf>.

11 Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore bën thirrje për parandalimin e dhunës në familje në kohë të pandemisë, Mars, 2020. Marrë nga: <https://womensnetwork.org/sq/grupi-per-siguri-dhe-barazi-gjinore-ben-thirrje-per-parandalimine-dhunes-ne-familje-ne-kohe-te-pandemise-covid19/?fbclid=IwAR0RtQFSWCKhOEFi2igROPI6wTfILj1j6TEQtUO9RuMUAGPlon0INcQnsE>.

12 *Corona Virus puts women in the frontline*, European Institute for Gender Equality, Mars, 2020; Marrë nga: <https://eige.europa.eu/news/coronavirus-puts-women-frontline>.

13 Korrespondencë e RrGK me përfaqësues të strehimoreve.

sociale. Sipas përfaqësuesve të strehimoreve, punëtorët socialë nuk i trajtojnë viktimat brenda strehimoreve nga frika e infektimit.

Si pasojë e mbylljes së përkohshme të shumë veprimtarive ekonomike, gratë dhe nënat vetëushqyese të cilave do t'u bartet barra e kujdesit dhe e punëve të shtëpisë, janë më të ekspozuara nga rreziku i shkeljes së të drejtave të tyre, sidomos nga ana e sektorit privat. Gratë e punësuar në këtë sektor, shpesh i përkasin sektorit joformal. Kjo e bën këtë kategori të grave shumë të ndjeshme ndaj riskut financiar, emocional dhe ekspozimit fizik ndaj virusit pa masa të duhura preventive, duke pasur parasysh se 30% e grave në këtë sektor punojnë pa kontratë¹⁴ dhe nuk mund të përfitojnë nga sigurimi social. Nga i njëjti rrezik janë të ekspozuara edhe gratë e vetëpunësuar në biznese familjare¹⁵, si dhe profesionet në të cilat gratë janë të mbi-përfaqësuar, si në infermeri, farmaci, aktivitete të shëndetit njerëzor dhe punës sociale¹⁶ dhe gratë në shërbime të shitjes¹⁷. Duke qenë se vazhdimi i punës në këta sektorë konsiderohet esencial, gratë pritet të pësojnë nga orari i gjatë i punës pa pagë shtesë¹⁸.

Edhe në kushte normale, përgjegjësitë e përkujdesjes mbi fëmijët dhe të moshuarit zakonisht bien mbi gratë¹⁹ si rrjedhojë e stereotipeve tradicionale të përkujdesjes. Me mbylljen e shkollave dhe vendeve të punës, barra e punës së papaguar të grave do të rritet²⁰. Edhe pse burrat dhe të moshuarit statistikisht po e pësojnë me fatalitet më shumë se gratë nga COVID 19²¹, barra e stërngarkuar e përkujdesjes i ekspozon gratë dhe vajzat ndaj pasojave²² tjera. Për nënat vetëushqyese, një situatë e tillë do të jetë edhe më e vështirë si pasojë e mbylljes së kopshteve. Një masë e nevojshme do të ishte ofrimi i shërbimeve publike të kujdesit në rastet e familjeve me një prind të punësuar në sektoret esenciale për luftimin e pandemisë, si në sektorin shëndetësor.

Edhe pse është paraparë dyfishimi i ndihmave sociale për disa kategori që përballen me varfëri të skajshme²³, normat e ndihmës sociale historikisht nuk kanë përmbushur shpenzimet për nevojat themelore të identifikuar

14 Instituti Riinvest, Women in the Workforce, p. 9. Marrë nga:

<https://www.riinvestinstitute.org/En/publications/249/women-in-the-workforce/>.

15 Anketa e Fuqisë Punetore, 2019, f.16.

16 Ne odën e infermierëve, janë të licencuar 9.873 gra dhe 2.321 burra, ndërsa në odën e farmacistëve janë të licencuara 1.072 gra dhe 400 burra. Statistikat e shëndetësisë, 2018. Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/5111/statistikat-e-shendetesise-2018.pdf>.

17 'Pothuajse gjysma e femrave të punësuar ishin: profesioniste, teknike dhe profesione që lidhen me to (40.3%), 22.6 % në shërbime dhe shitje dhe 11.7% ishin në profesione elementare.' Anketa e Fuqisë Punetore, 2019, f.20.

18 Corona Virus puts women in the frontline, European Institute for Gender Equality, Mars, 2020; Marrë nga: <https://eige.europa.eu/news/coronavirus-puts-women-frontline>.

19 'Males spend, on average, 400% more time on employment than females (3.9 hours and 0.9 hours, respectively). In contrast, women spend 300% more time on household and family care than men (7.1 hours and 2.3 hours, respectively). Marrë nga: https://millenniumkosovo.org/wp-content/uploads/2018/11/MCC-Kosovo-Labor-Force-and-Time-Use-Study-Final-Research-Report-1.pdf?fbclid=IwAR2orggGM905tV_nUËsLYP5flu0Dks7cxAi5Qvq_FëPuk9yei46q8ErNPE.

20 Ibid.

21 Begley, "WHO is Getting Sick," Stat.

22 Care International, The Gender Implications of Covid-19 outbreaks in development and humanitarian settings, 2020; Marrë nga:

https://www.care.org/sites/default/files/gendered_implications_of_covid-19_-_full_paper.pdf.

23 Pako emergjente fiskale e qeverisë së Republikës së Kosovës, Mars, 2020. Marrë nga: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,2,851>.

në indeksin e çmimeve të konsumit. Një gjë e tillë është edhe më pak e pritshme, në rrethanat e pandemisë kur nevojat dhe shpenzimet janë shtuar. Përderisa burrat përbëjnë shumicën e personave që fizikisht i marrin ndihmat sociale (60%) në emër të familjeve të tyre, shumica e anëtarëve të familjes që varen nga ndihma sociale janë gra (60-65%)²⁴. Pamundësia e qasjes së tyre direkte në asistencë sociale, mund të kufizojë plotësimin e nevojave të tyre bazike sanitare dhe higjienike.

Gratë përbëjnë 70% të sistemit shëndetësor në tërë botën²⁵. Edhe në Kosovë, më shumë gra janë të punësuar në institucionet shëndetësore në krahasim me burrat, me diferencë prej 18%²⁶. Edhe pse në Kosovë mungojnë statistikatat sa i përket hendekut gjinor në këtë sektor, globalisht mesatarja e hendekut gjinor në sistemin shëndetësor është 28%²⁷. Si pasojë e këtyre rrethanave, gratë në sistemin shëndetësor janë dyfish më të rrezikuara nga situata e pandemisë, përtej ekspozimit ndaj virusit, por edhe si pasojë e mos-plotësimit të nevojave të tyre financiare, higjienike dhe psiko-sociale.

Edhe pse qeveria ka siguruar arritjen e rreth shtatë mijë testeve për të testuar pacientët që mund ta kenë Virusin COVID-19²⁸ më qëllim lokalizimi dhe parandalimi, asnjë plan buxhetor për një shpërndarje masive të testeve në shtëpia për testim të të gjithë popullatës nuk është bërë publik. Ndarja e këtyre testeve do të duhej të marrë parasysh pabarazinë në qasje që ekziston te burrat dhe gratë e ndryshëm: që jetojnë në zona rurale, me aftësi dhe përkatësi etnike të ndryshme. Po ashtu, qeveria ka rialokuar shumë prej 10 milionë eurove për zbatim të Planit të Veprimit kundër COVID-19.²⁹ Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, një analizë gjinore dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor duhet të përfshihen në zbatimin e këtij plani. Gjithashtu, duke konsideruar situatën, rialokime të linjave buxhetore në Ligjin 07/L-001 për Buxhet për vitin 2020, duhet të bëhen sipas nevojave të ndryshme për të gjithë grupet shoqërore të identifikuar nga analiza gjinore.

Integrimi i perspektivës gjinore në masat e marra nga qeveria si përgjigje ndaj krizës shëndetësore dhe ekonomike, është e rëndësishme meqenëse barra e ofrimit të shërbimeve sociale kalon nga domeni publik – shteti, në atë privat – shtëpia. Po ashtu, për shkak të izolimit, me rënie në ofertë përmes uljes së aktiviteteve ekonomike në prodhim dhe me rënie në

24 Rrjeti i Grave të Kosovës, 'Buxhetimi drejt Mirëqenies sociale, Analizë gjinore+ për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016-2018'. Marrë nga: <https://womensnetwork.org/ep-content/uploads/2018/10/20151203094304881.pdf>.

25 The COVID-19 Outbreak and Gender, Gender in Humanitarian Action (GiHA), 2020. Marrë nga: <https://eë2.unwomen.org/-/media/field%20office%20easia/docs/publications/2020/03/ap-giha-eg-advocacy.pdf?la=en&vs=2145>.

26 Analiza Gjinore e Kosovës, 2018, RrGK; Marrë nga: <https://eomensnetëork.org/ep-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>.

27 WHO (2019). Gender equity in the health work force: Analysis of 104 countries.

28 Koha, Rreth 7,000 teste për koronavirus arrijnë në Kosovë, Mars, 2020. Marrë nga: https://www.koha.net/arberi/215047/rreth-7-000-teste-per-koronavirus-arrijne-ne-kosove/?fbclid=IwAR0A8yI21pliAiQ8uM48gFkcH5w-WMW1SqjC0n8vxTtQDoy_U7Ld7m-AB30.

29 Qeveria e Kosovës ndau 10 milionë euro kundër koronavirusit, Mars, 2020. Marrë nga: <https://www.aa.com.tr/sq/balkani/qeveria-e-kosoves-ndau-10-milione-euro-kunder-koronavirusit/1761222>.

kërkesë, përmes tentimit të qytetarëve për të kursyer, barra e krizës dhe rimëkëmbja nga ajo bie te shtëpia, si agjent ekonomik i rimëkëmbshëm, ku grave ju bie përgjegjësia kryesore e punëve të papaguara të kujdesit për shkak të roleve gjinore dhe normave shoqërore.

Përkundër faktit që, edhe pse jo e balancuar, përbërja e Komisionit të Posaçëm për parandalimin e përhapjes së COVID-19 dhe ajo e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e incidenteve në Kosovë reflekton përfaqësim institucional nga një numër minimal i grave në pozita udhëheqëse në media dhe në front të prononcimeve publike aktualisht shohim vetëm burra, të cilët e adresojnë situatën në Kosovë nga një perspektivë neutrale. Kjo nënkupton se edhe në kohë pandemie mos përfaqësimi i pa barabartë në procese vendimmarrëse shtyen në krijimin e politikave të verbra gjinore (gender blind)³⁰. Lënia jashtë e grave në hartimin e politikave që i afektojnë vetë gratë në rrethana epidemie, nënkupton që nevojat e grave në botë dhe përkatësisht edhe në Kosovë nuk do të identifikohen dhe adresohen³¹.

Duke marrë parasysh rëndësinë e një analize gjinore që do të mund të identifikonte nevojat e ndryshme të grave dhe burrave gjatë kësaj epidemie, mënyrat e ndryshme të ndikimit nga COVID-19, dhe e cila do të informonte politikën publike afatgjatë dhe afatshkurtra, qoftë në aspektin ekonomik, shëndetësor, apo social, Rrjeti i Grave të Kosovës thërret Qeverinë për zbatim të rekomandimeve të mëposhtme:

Për Qeverinë e Kosovës

- Të implementohet urgjentisht analizë gjinore gjithëpërfshirëse, për të informuar dhe orientuar masat e mëtutjeshme të qeverisë. Planet strategjike shtetërore dhe masat parandaluese kundrejt COVID-19 duhet të jenë të bazuara në analizë gjinore dhe të kenë integruar vlerësimin e ndikimit gjinor në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore dhe legjislacionin ndërkombëtar, duke marrë për bazë stereotipet gjinore, rolet gjinore, ndarjen e pabarabartë të përgjegjësisë të kujdesit mes grave dhe burrave dhe dinamikën tjerë që rrjedhin si pasojë e këtyre të fundit. Karakteri informativ i analizës paraprake gjinore, do të sigurojë që masat e parandalimit dhe të mitigimit që ndërmirren në vijim do të adresojnë edhe barrën e punës së papaguar të grave dhe rritjen e rrezikut të ekspozimit ndaj dhunës në baza gjinore. Inkuadrimi i vlerësimit të ndikimit gjinor në kuadër të zbatimit të Analizës së Përgjithshme të Ndikimit Rregullator (ANRR), kontribuon në integrimin e denjë të perspektivës gjinore pasi që është një nga mjetet e ANRR-së që duhet të aplikohet njëkohësisht sa herë që propozohet, hartohet apo vlerësohet ndonjë kornizë e re rregullative³².

30 'Despite the WHO Executive Board recognizing the need to include women in decision making for outbreak preparedness and response, there is inadequate women's representation in national and global COVID-19 policy spaces'; WHO, Executive Board EB146/Conf/17: *strengthening preparedness for health emergencies; implementation of International Health Regulations*, IHR (2005). World Health Organization, Geneva 2020

31 Harman S, Ebola, Gender and conspicuously invisible women in global health governance. Third World Quart. 2016.

- Të përfshihen më shumë gra në hartimin e planeve dhe politikave për t'i bërë ballë virusit COVID-19 dhe në propozimin e masave me karakter afatshkurtër apo afatgjatë, sidomos sa i përket aspektit të mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe dhunës në baza gjinore. Përfshirja e më shumë grave në pozita udhëheqëse dhe atyre që janë pjesë të sistemit shëndetësor në komisione dhe procese vendimmarrëse ndihmon që të adresohen proporcionalisht nevojat e grave dhe vajzave nga secili komunitet, njëherit një praktikë e tillë është në harmoni me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurisë së OKB-së për përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse, parandalimin e konfliktit dhe ndërtimit të paqes³³.

Për Ministrinë e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike dhe Ministrinë e Shëndetësisë

- Të ndërmerren masa speciale dhe përpjekje të vazhdueshme në kuadër të masave afatmesme për të identifikuar shkeljet e të drejtave nga sektori i ekonomisë jo formale, duke i adresuar nevojat e grave të cilat përbëjnë një pjesë dërmuese të këtij sektori, në mënyrë që të përfshihet edhe kjo kategori në grupin e përfituesve nga skemat mbështetëse financiare për sektorin privat.
- Të adresohet barra e punës së papaguar të grave nga Inspektorati i Punës, dhe të specifikohen masat të cilat do të ndërmerren në raport me shpërndarjen e asistencave sociale, shërbimeve psiko-sociale, dhe shërbimeve mjekësore-higjienike.
- Të monitorohet shkelja e të drejtave të punës në sektorin privat, sidomos në sektorët esencialë të mbipërfaqshuar nga gratë, si pasojë e orarit të tejzgjatur të punës pa pagesë shtesë.
- Të njihet puna e papaguar e kujdesit e specifikuar në nenin 18 të Ligjit për Barazi Gjinore³⁴ si pjesë e sistemit të ekonomisë, sidomos gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave dhe masave makroekonomike si përgjigje ndaj pandemisë. Kjo mund të bëhet duke e modifikuar lejen për mungesë nga puna, dhe duke inkurajuar që kjo e fundit të ndahet mes dy prindërve, apo duke e bërë të mundur që gratë të përfitojnë nga provizionet publike për kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve. Një praktikë e tillë duhet të aplikohet sidomos në sektorët esencialë, ku puna është duke vazhduar dhe fëmijët apo të moshuarit rrezikojnë të mbesin pa përkujdesje adekuate.

32 *Manuali për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë gjinore*, Agjencia për Barazi Gjinore, Nëntor 2019. Marrë nga: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Manuali%20p%C3%ABr%20Vler%C3%ABsimin%20e%20Ndikimit%20t%C3%AB%20Barazis%C3%AB%20Gjinore.pdf>.

33 *Resolution 1325 (2000)* [S/RES/1325 (2000)].

34 'Subjektet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të trajnimit profesional bazuar në legjislacionin në fuqi.' *Ligji për Barazi Gjinore*, Neni 12, 2015.

- Të sigurohen të dhënat e ndara sipas gjinisë, të cilat janë tejet të nevojshme për të kuptuar se si gratë dhe burrat janë të afektuar ndryshe nga ky virus, jo vetëm në kontekstin e infektimit, por edhe në aspektin ekonomik, ndarjen e përgjegjësisë të kujdesit dhe për të treguar shkallën e rritjes së dhunës në familje. Një praktikë e tillë duhet të përfshihet edhe nga linjat e ministrive përkatëse qendrore si dhe në nivel lokal në kuadër të zbatimit të planit të reagimit kombëtar. Konsultimi paraprak me organizata të cilat kanë ekspertizë në lidhje me çështjet e barazisë gjinore është i domosdoshëm, dhe si i tillë, rekomandohet edhe në kuadër të planit të reagimit kombëtar³⁵.
- Të integrohen nevojat e infermiereve dhe mjekeve në secilin plan strategjik kundrejt COVID-19. Të sigurohet që grave infermiere dhe mjeke, si dhe grave në profesione tjera në sistemin shëndetësor t'u plotësohen nevojat esenciale higjienike dhe sanitare, përfshirë këtu sigurimin e produkteve menstruale dhe pecetave higjienike. Kjo nënkupton që ato të jenë të pajisura mjaftueshëm për të mbajtur higjienën personale dhe të jenë të mbrojtura përderisa shërbejnë në rradhët e para të shërbimeve shëndetësore.

Rekomandime në raport me dhunën në baza gjinore

- T'u jipet përparësi shërbimeve për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje në mes të pandemisë COVID-19, përfshirë këtu financimin e qëndrueshëm të OJQ-ve, strehimoreve dhe qendrave ditore që janë në shërbim të viktimave të dhunës me baza gjinore. Të sigurohet që këto qendra kanë mjaftueshëm mjete të nevojshme mjekësore, higjienike dhe sanitare.
- Të hartohet një protokoll i procedurave që duhet ndjekur për trajtimin e grave të cilat nuk mund të pranohen në qendra të tilla, si pasojë e infektimit, duke përfshirë karantinim të sigurtë dhe qasje në testim. Të sigurohet trajtim psiko-social i viktimave të dhunës me baza gjinore, qoftë edhe në mënyrë virtuale.
- Të specifikohen masat që do të ndërmerren në raport me dhunën në baza gjinore, duke përfshirë inkurajimin e vazhdimin të punës së Mbrojtësve të Viktimave dhe të sigurohet gatishmëria e policisë në trajtimin emergjent të rasteve të dhunës. Të informohet publiku për vazhdimësinë e punës së këtyre institucioneve.
- Të sigurohet që punëtorët shëndetësorë të kenë përgjigje të ndjeshme gjinore ndaj rasteve të dhunës në baza gjinore të cilët mund të shoqërohen ose përkeqësohen nga pandemia. Ata të cilët ofrojnë

35 'OJQ-të bashkëpunojnë me reaguesit e parë, pushtetin e të dyja niveleve, agjencitë dhe organizatat tjera që ofrojnë shërbime ndihmash për mbështetjen jetësore, zvogëlimin e dhimbjeve fizike dhe emocionale dhe përkrahin rimëkëmbjen e viktimave të fatkeqësisë, kur ndihma nuk është e mundur nga burimet tjera', Plani i Reagimit Kombëtar, 2010. Marrë nga: https://ame.rks.gov.net/Portals/0/Files/Plani%20Reagimit%20Kombetar_14_01_11.pdf.

përgjigjen e parë duhet të dinë se kujt i duhet kujdes i shtuar, ose kë duhet sjellur në qendra trajtimi.

Për Ministrinë e Financave

- Të bëhet rishikimi i buxhetit afatmesëm duke praktikuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, dhe vlerësimin e ndikimit gjinor, të paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore, dhe duke pasur parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave gjatë kësaj epidemie.

Për donatorët e huaj në Kosovë

- Te gjitha fondet e pranuar nga BE duhet të shpërndahen duke pasur parasysh parimet e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) dhe në kuader të nevojave të identifikuar nga analiza gjinore.
- Të përfshihen nën ombrellën e fondeve të Bashkimit Evropian të cilat do t'i distribuohen Kosovës për të adresuar nevojat e menjëhershme dhe ato afatgjata të vendit gjatë kësaj epidemie, mes tjerash, trajtimi psiko-social i viktimave të dhunës me baza gjinore, financimi i qëndrueshëm afatgjatë i strehimoreve, pajisja me mjete të nevojshme higjienike dhe sanitare, si dhe aspekte tjera përcjellëse të mbrojtjes sociale dhe ekonomike të grave si pjesë e grupeve të marginalizuara, sic theksohet në deklaratën e Bashkimit Evropian për planifikimin e shpërndarjes së këtyre fondeve³⁶.

³⁶ EU mobilises immediate support for its Western Balkan partners to tackle coronavirus, European Commission, 2020. Marrë nga: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_561.